



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
SOCIOLINGUISTIKË

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti i parë, semestri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e lëndës: Të kuptuarit dhe trajtimi i koncepteve kryesore të sociolinguistikës, përfshirë varietetin gjuhësor, normat gjuhësore, komunitetet gjuhësore dhe identitetin gjuhësor. Të kuptuarit e marrëdhënies mes gjuhës dhe shoqërisë, se si gjuha është e lidhur ngushtë me faktorët shoqërorë, përfshirë klasën sociale, gjininë, etninë dhe kontekstin kulturor. Të analizuarit e varietetit gjuhësor brenda komuniteteve gjuhësore të gjuhës frënge dhe të gjuhës së shenjave. Të kuptuarit e mekanizmave të ndikimit shoqëror në gjuhë: se si faktorët shoqërorë si klasa sociale, gjinia, dhe të tjerët ndikojnë në strukturën dhe përdorimin e gjuhës në komunitetet e gjuhës frënge dhe të gjuhës së shenjave.

Objektivat Specifike:

- Të zhvilluarit e aftësitë për të analizuar dhe dokumentuar variabilitetin gjuhësor brenda komuniteteve të gjuhës frënge dhe të gjuhës së shenjave, duke përdorur metoda të sociolinguistikës.
- Të studiuarit e identitetit gjuhësor
- Njohja mbi dialektet dhe të folmet franceze.
- Njohja e kulturës së personave që nuk dëgjojnë

Rezultatet e të nxënit: Pas përfundimit të modulit të sociolinguistikës, studentët duhet të jenë në gjendje të:

- Të kuptojnë dhe përdorin terminologjinë dhe metodologjinë e sociolinguistikës për të analizuar komunitetet e gjuhës frënge dhe të gjuhës së shenjave.
- Të analizojnë varietetet gjuhësore dhe të identifikojnë mënyrat se si faktorët shoqërorë ndikojnë në gjuhën dhe identitetin gjuhësor.
- Të kuptojnë se si gjuha dhe identiteti gjuhësor ndikojnë në komunikimin dhe marrëdhëniet ndërmjet individëve dhe komuniteteve në kontekstin e gjuhës frënge dhe të gjuhës së shenjave.